



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 28.2.2025

Nr: 224

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA ALEANCA
SOCIALISTE SHQIPTARE”, ME KRYETAR Z. GEZIM ALIBALI, PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË
DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 28.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 1299 prot., datë 25.2.2025, me:

KËRKUES: Partia politike “Partia Aleanca Socialiste Shqiptare”, me kryetar Z. Gezim Alibali

OBJEKTI: Regjistrimi i partisë politike “Partia Aleanca Socialiste Shqiptare”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025

BAZA LIGJORE: Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

“Partia Aleanca Socialiste Shqiptare”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Gezim Alibali, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Data: 28.2.2025 Nr: 224
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Aleanca Socialiste Shqiptare”, me Kryetar Z. Gezim Alibali, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 25.2.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Aleanca Socialiste Shqiptare”, me iniciale “PASSH”, me Kryetar Z. Gezim Alibali, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është: “Partia Aleanca Socialiste Shqiptare” me shkronja nistore “PASSH”, me adresë: Rruga "Thanas Ziko", Pll. 65/1, nr. 5, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është: Z. Gezim Alibali, me adresë: Lgj. "N.Mazi", Rruga "E. Durham", Pll. 1193, Shkodër;
- c) Financieri i partisë është: Zj. Fatjona Bizi, me adresë: Lgj. "Ahmet Haxhia", Rruga "Omarej", Shkodër;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është Z. Dritan Hoti, me adresë: Rruga "I.Kodra", Nd. 1, Ap. 16, Nj. nr. 5, 1019, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Aleanca Socialiste Shqiptare”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Aleanca Socialiste Shqiptare” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Aleanca Socialiste Shqiptare”, me kryetar Z. Gezim Alibali, me shkronjat nistore “PASSH”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI